



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

PAKR.nr.201/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS-Departamenti për Krime të Rënda, kolegji i përbërë nga gjyqtarët Vaton Durguti, kryetar, Dr.sc. Driton Muharremi dhe Afrim Shala anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Leonita Lajçi si procesmbajtëse, në lëndën penale ndaj të akuzuarit **A.GJ.** nga fshati ..., Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale të vrasjes nga neni 178 të KPRK-së, veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të pa autorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së si dhe ndaj të akuzuarit **P.GJ.** nga fshati ..., Komuna e Gjakovës për shkak të veprës penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së, duke vendosur përkitazi me ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjakovë -Departamenti për Krime të Rënda, ankesa e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara V. dhe K.B. dhe ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve A.GJ. dhe P.GJ. të paraqitura kundër aktgjyqimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr.64/19 të dt. 16.02.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur konform nenit 390 të KPPK, me datë 16.06.2021 morri këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohen si të pabazuara ankesa e Prokurorisë Themelore në Gjakovë – departamenti për krime të rënda, ankesa e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara dhe ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve A.GJ. dhe P.GJ., kurse aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda PKR.nr.64/19 të dt. 16.02.2021, **vërtetohet.**

A r s y e t i m

Gjykata Themelore-Departamenti për Krime të Rënda në Gjakovë, me aktgjykimin PKR.nr.64/19 të dt. 16.02.2021, të akuzuarin **A.GJ.** e ka shpallur fajtor për veprën penale të vrasjes nga neni 178 të KPRK-së, të përshkruar si në pikën.I të dispozitivit të këtij dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) vite burgim. E ka shpallur fajtor për veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 par.3 nënpar 3.1 lidhur me par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, të përshkruar si në pikën.II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej tre (3)vite e gjashtë (6) muaj si dhe e ka shpallur fajtor për veprën penale mbajtja mbajtja në pronësi kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së të përshkruar si në pikën. III të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe i ka shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 1(një) vit e gjashtë (6) muaj dhe konform nenit 80 par.2 të KPRK-së i ka shqiptuar dënimin unik me burgim në kohëzgjatje prej **njëzet e dy (22) vite**, në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 12..03.2019 gjerë në plotfuqishmërinë e aktgjyqimit. Të akuzuarin **P.GJ.** e ka shpallur fajtor për veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale vrasje nga neni 178 lidhur me nenin 33 të KPRK-së dhe i ka

shqiptuar dënimin me burgim në kohëzgjatje prej **dymbëdhjetë (12) vite**, në të cilin dënim do të i llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 16.02.2021, gjerë në plotfuqishmërinë e aktgjykimit. Ndaj të akuzuarit A.GJ., konfiskohet : një (1) pushkë automatike “Type-68”, e kalibrit 7.62x39mm, me numër serik: 10282508, një prodhim kinez, së bashku me një (1) karikator dhe pesëmbëdhjetë (15) fishek, të kalibrit 7.62 x 39 mm, si objekt i kryerjes së veprës penale. Urdhërohet Stacioni Policor në Gjakovë, që pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi të bëjë shkatërrimin e armës dhe municionit të konfiskuar, që në polici evidentohen sipas numrit të rastit 2019-EA-243. **Detyrohen** të akuzuarit që ti paguajnë shpenzimet e paushallit gjyqësor secili veç e veç në shumën prej katërqind (400) euro, si dhe në emër të programit për kompensimin e viktimave të krimit secili veç e veç shumën prej pesëdhjetë (50) Euro , ndërsa i akuzuari A.GJ. edhe shpenzimet e procedurës penale dhe atë : për ekspertizën mjeko ligjorë shumën prej njëzet (20) euro, për dëgjimin e dy ekspertëve mjeko ligjorë në shqyrtimin gjyqësor shumën prej njëqind (100) Euro, të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi. Të dëmtuarit K. (M.1.) B., V. (M.2.) B. dhe A. (M.) N., që të tre nga fshati ..., Komuna e Gjakovës, për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko-civil.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë kanë ushtruar:

-Prokuroria Themelore në Gjakovë -Departamenti për Krime të Rënda për shkak të vërtetimit të gabuar ose jo të plotë të gjendjes faktike, për shkak të shkeljes së ligjit penal dhe për shkak të vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr.64/19 të dt. 16.02.2021, ta Prishë dhe lëndën t’ia kthej të njëjtës Gjykatë në rigjykim dhe rivendosje.

-Përfaqësuesja e palëve të dëmtuara V. dhe K.- B. av. N.B. për shkak të vendimit mbi dënim me propozim që të aprovohet ankesa e të dëmtuarve sa i përket vendimit mbi dënim, të ndryshohet aktgjykimin i shkallës së parë, ashtu që ndaj të akuzuarve të i shqiptohet dënim më i rëndë për veprën e kryer.

-Mbrojtësi i të akuzuarit A.GJ. av. Kosovare Kelmendi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e atakuar ta ndryshojë sa i përket kualifikimit juridik të veprës në dispozitivin I të aktgjykimit të atakuar për të akuzuarin A.GJ. ashtu që për atë pikë të aktakuzës, të njëjtin ta shpallë fajtor për veprën penale lëndim i rëndë trupor me pasojë vdekjen nga neni 186 par.5 lidhur me par.7 të KPRK-së ose çështjen t’ia kthej gjykatës së shkallës së parë në rigjykim ndërsa sa i përket pikës II dhe III i njëjti të ndryshohet sa i përket vendimit mbi dënim, të shqiptohet një dënim më i butë.

-Mbrojtësi i të akuzuarit P.GJ. av. Tom Gashi për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, vërtetimit të gabueshëm dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkeljes së ligjit penal dhe vendimit mbi dënimin me propozim që Gjykata e Apelit ta ndryshoj aktgjykimin e atakuar dhe z.P.GJ. ta liroj nga akuza ose çështjen ta kthej në rigjykim dhe rivendosje. Në rast se Gjykata nuk i aprovon propozimet më lartë atëherë mbrojtja e të akuzuarit propozon që Gjykata e Apelit ta ndryshoj vendimin mbi dënimin e shqiptuar ashtu që z.P.GJ. ti shqiptoj dënim më të butë, mundësisht dënimin me kusht.

-Përgjigje ndaj ankesës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda kanë parashtruar mbrojtësit e të akuzuarve A.GJ. av. Kosovare Kelmendi dhe P.GJ. av. Tom

Gashi me propozim që ankesa e PTH e ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjakovë PKR.nr.64/19 të dt. 16.02.2021 të refuzohet si e pa bazë sa i përket vendimit mbi dënim ndërsa sa i përket propozimit që Aktgjykimi i Gjykatës Themelore të prishet dhe rasti të kthehet në rigjykim dhe rivendosje ajo të aprovohet.

-Përgjigje ndaj ankesës së përfaqësueses së palëve të dëmtuara V. dhe K.B. av. N.B. kanë dhënë mbrojtësit e të akuzuarve A.GJ. av. Kosovare Kelmendi dhe P.GJ. av. Tom Gashi me propozim që Gjykata e Apelit – Departamenti për Krime të Rënda të njëjtën ta refuzoj si të pabazuar.

-Përgjigje ndaj ankesave të të akuzuarve A.GJ. dhe P.GJ. ka dhënë përfaqësuesja e palëve të dëmtuara V. dhe K.B. av. N.B. me propozim që Gjykata e Apelit – Departamenti për Krime të Rënda ti refuzoj si të pabazuara.

Gjykata e Apelit caktoi seancën e kolegjit duke njoftuar palët për datën dhe vendin e mbajtjes së seancës, ku prezantuan të akuzuarit A.GJ., P.GJ. dhe mbrojtësit e tyre av. Kosovare Kelmendi dhe av. Tomë Gashi, të dëmtuarit V. B. dhe A. N. si dhe përfaqësuesi i palës së dëmtuar av. N.B. ndërsa munguan Prokurori i Apelit i cili mungesën se ka arsyetuar dhe e dëmtuara K.B. e cila gjendet në Zvicër.

-Prokurori i Apelit në parashtrësën PPA/I.nr.208/21 të dt.27.05.2021 ka propozuar që të aprovohen si të bazuara ankesat e Prokurorisë Themelore në Gjakovë-Departamenti për Krime të Rënda, ankesa e përfaqësuesit të palëve të dëmtuara V. dhe K.B. kundër aktgjykimit të shkallës së parë ashtu që aktgjykimi të anulohet dhe çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje. Të refuzohen si të pabazuara ankesat e mbrojtësve të të akuzuarve A.GJ. av.Kosovare Kelmendi dhe P.GJ. av.Tom Gashi si dhe përgjigjet në ankesën e PTH dhe ankesën e përfaqësuesit të të dëmtuarve

Gjykata e Apelit, e shqyrtoi aktgjykimin e ankimuar, detyrimisht në kuptim të dispozitës së nenit 394 par.1 të KPPK, vlerësoi pretendimet ankimore të prokurorisë, së bashku me shkresat tjera të lëndës dhe pas vlerësimit të shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesat janë të pa bazuara

Në ankesën e Prokurorisë Themelore në Gjakovë pretendohet që gjendja faktike nuk është vërtetuar drejtë dhe se gjykata në mënyrë të gabuar ka bërë konstatimin e gjendjes faktike kur ka bërë rikualifikimin e veprës penale të përshkruar në dispozitivin nën dy të aktakuzës nga vepra penale vrasje në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së, në veprën penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi.3 nënparagrafi.3.1 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi.1.3 të KPRK-së duke konstatuar se nuk është vërtetuar dashja e të pandehurit që ta privoj nga jeta të dëmtuarin A. N. dhe mbi këtë bazë gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të pandehurit të përshkruara në pikën dy të dispozitivit të aktgjykimit ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale lëndim i rëndë trupor nga neni 186 paragrafi.3 nënparagrafi.3.1 lidhur me paragrafin 1 nënparagrafi.1.3 të KPRK-së. Sipas Prokurorisë nuk është kontestuese se i pandehuri A.GJ. me datë 12.03.2019 rreth orës 18:35 në fshatin ... Komuna e Gjakovës pikërisht afër shtëpisë së A. N. me dashje ka tentuar ta privojë nga jeta të dëmtuarin A. N. nga fshati ... Komuna e Gjakovës, në atë mënyrë që pasi ka shtënë me armë fillimisht në automjetin dhe në viktimën – tani të ndjerin T. B. në vendin kohën dhe mënyrën e përshkruar si në pikën nën I të dispozitivit të aktgjykimit, i **dëmtuari** me qëllim që ta ndal i del përpara të pandehurit dhe me atë rast i njëjti me armën automatike “Typ 68”, shkrep në drejtim të tij një plumb duke e goditur në këmbën e majtë

pikërisht në të dy kërcirrit në pjesën e sipërme të kockës së brendshme dhe pasi i dëmtuari rrëzohet në tokë e sulmon duke e goditur në kokë në regjionin e vetullës së djathtë me kondak të pushkës, me ç'rast të dëmtuarit i shkakton lëndime të rënda trupore, lëndime këto të konstatuara dhe të përshkruara në ekspertizën mjeko-ligjore të dt. 05.06.2019 të hartuar nga eksperti mjeko ligjor Dr.D. H. andaj Prokuroria vlerëson se në rastin konkret ekzistojnë të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes në tentativë nga neni 178 lidhur me nenin 28 të KPRK-së. Po ashtu në ankesën e Prokurorisë pretendohet që Gjykata e shkallës së parë nuk i ka peshuar drejtë gjatë matjes së dënimit rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese për dy të akuzuarit A. dhe P.GJ. në të kundërtën të njëjtëve do t'u shqiptohej një dënim më i rëndë duke marr parasysh shkallën e lartë të dashjes tek i akuzuari **A.GJ.** pasi që i njëjti ishte nisur nga shtëpia e tij me pushkë automatike dhe sapo kishte arritur në vendin e ngjarjes kishte gjuajtur dhjetë fishek në drejtim të veturës në të cilën ishte viktimja dhe pasi i dëmtuari A. ishte munduar që ta ndal pra ta pengonte, i pandehuri kishte shtënë në drejtim të tij në këmbë dhe pastaj me kondak të pushkës e kishte goditur në kokë dhe përsëri kishte shtënë në drejtim të viktimës T. B. për ta privuar nga jeta, kjo tregon vendosmërinë e tij për kryerjen e veprës penale , pastaj mënyra e kryerjes të veprës penale, rrezikimi dhe dëmtimi i vlerës së mbrojtur pasi i pandehuri ka cenuar vlerat më të larta të mbrojtura me ligj siç është jeta e njeriut shkallën e lartë të dëmit që i ka shkaktuar familjes së viktimës ndërsa për të akuzuarin **P.GJ.** si rrethana rënduese gjykata ka marr shkallën e lartë të dashjes te i pandehuri, i njëjti kishte thirrë në telefon të pandehurin A. po sa kanë dal nga oda e të dëmtuarit A., nuk kishte larguar automjetin e tij për të lëvizur i ndjeri andaj Prokuroria vlerëson që këto rrethana nuk janë peshuar drejtë gjatë matjes së dënimit për të pandehurit A. dhe P.GJ. në të kundërtën të njëjtëve do u shqiptohej një dënim më i lartë duke marrë parasysh që të njëjtit nuk kanë qenë në asnjë mënyrë të provokuar nga tani i ndjeri , por përkundrazi i njëjti ishte angazhuar me çdo kusht për arritjen e një marrëveshje me të pandehurit për parcelën e blerë kohë më parë nga një familjar i të pandehurve.

-Mbrojtësja e të akuzuarit A.GJ. av.Kosovare Kelmendi në ankesën e saj pretendon se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale pasi që dispozitivi i aktgjykimit është i pakuptueshëm, konfuzë, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyetimin në raport me të akuzuarin A.GJ. por edhe me të akuzuarin P.GJ.. Nuk janë paraqitur arsyet lidhur me faktet vendimtare ndërsa ato të paraqitura janë të paqarta dhe kundërthënëse. Nuk është bërë vlerësimi i saktësisë së provave kundërthënëse si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e zgjedhjes së kësaj çështje juridike e veçanërisht me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale. Në veçanti përmbajtja e bisedës telefonike në mes të të akuzuarit P. dhe A. pak minuta para ngjarjes kritike e cila sipas dispozitivit rezulton të jetë “ Jam te shtëpia e A. M.3.it” ndërkaq ky konstatim nuk vërtetohet me asnjë provë materiale. Njëjtë konstaton edhe për përmbajtjen e një bisede se “ i pandehuri P.GJ. pasi që nuk janë pajtuar duke dal jashtë e telefonon të pandehurin A. të cilin e njofton se nuk kanë arritur marrëveshje”. Pra edhe kjo pa ndonjë mbështetje në prova e pikërisht nga kjo varet edhe rrjedha e ngjarjes kritike, motivi, dashja si dhe elementet tjera me rëndësi. Shkelje tjetër kemi me rastin e refuzimit të propozimit të mbrojtjes së të akuzuarit A.GJ. për ekzaminimin psikiatrik të tij lidhur me kohën e kryerjes së veprës penale e paraparë sipas nenit 508 par.1 nënpar.1.1 të KPP. Aktgjykimi nuk është përpiluar konform nenit 370 par.7 të KPP, duke shkelë kështu dispozitën e nenit 384 par.1 pika 12 të KPP. Po ashtu shkelje kemi edhe sa i përket deklaramit për pranimin e fajësisë për të akuzuarin A., ashtu që në shqyrtimin fillestarë të datës 11.12.2019 Gjykata ka konstatuar “ se i akuzuari A.GJ. nuk dëshiron të deklarohe lidhur me fajësinë” dhe këtë përgjigje e ka konsideruar si mos pranim të fajësisë ndërsa në procesverbalin e shqyrtimit kryesorë ka theksuar Gjykata “ i akuzuari A.GJ. deklaroi se unë i pranoj veprat penale dhe e pranoj armëmbajtjen pa leje por vrasjen në tentativë nuk e pranoj që e kam kryer me dashje” (që i bie që nuk e pranon pikën II të dispozitivit të aktakuzës ndërsa nuk merr fare Gjykata aktvendim mbi pranimin e fajësisë për asnjërën pikë të dispozitivit apo

refuzimin e pranimit të fajësisë, ndërkaq i akuzuari A. në fazën e mbrojtjes është mbrojtur në heshtje).

Mbrojtja vlerëson se edhe gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë ashtu që ngjarja në ditën kritike nuk ka ndodhur ashtu sikur që është arsyetuar në aktgjykim dhe atë jo vetëm në raport me të akuzuarin A. por as me të akuzuarin P.GJ.. Gjykata nuk ka vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë faktet vendimtare lidhur me veprën penale të vrasjes përkatësisht analizën e provave të administruara e ka bërë gabimisht dhe kështu është nxjerrë për pasojë përfundimi i gabuar. Vërtetimi i gabuar i gjendjes faktike ndërlidhet me elementin subjektiv të veprës penale-dashjen dhe kontestin pronësor si motivë. Konflikti pronësorë ka ekzistuar në mes të P.GJ. dhe vëllait të tij M.2.it si iniciator i konfliktit i cili tinëzisht ka shitur një pjesë të pronës së përbashkët familjare dhe i ka ikur apo shmangur zgjidhjes së problemit pronësorë ndërsa prokuroria e as gjykata nuk ka marrë mundin që ta ftojë në cilësinë e dëshmitarit për ti sqaruar rrethanat dhe faktet relevante lidhur me mospajtimet mes T. B.t dhe P.GJ. ditën kritike. Kjo është e rëndësishme bazuar edhe në deklaratën e V. B.t të dhënë me datë 25.06.2020 në shqyrtimin kryesor. I akuzuari A. nuk ka qenë prezent e as i ftuar në takim në shtëpinë e A. N. dhe në këtë kohë të bisedave ishte në shtëpi duke fjetur ku ishte edhe nëna e tij J. ndërsa biseda zhvillohej diku në largësi prej 300 metrave në vijë ajrore dhe se ishte pikërisht nëna e tij e cila e kishte zgjuar nga gjumi duke i thënë se “A. qu se po ndihen britmat dhe zërat prej shtëpisë së A.it” dhe kështu A.i në atë gjendje të përgjumur dhe të trishtuar nga zëri dhe fjalët e nënës së tij duke nxituar e merr pushkën që ka qenë në sallon dhe brenda 3 minutave arrin tek shtëpia e A.it ku duke qenë errësirë, duke egzistuar britma dhe zëra, fakti se kishte një problem pronësor dhe duke mos qenë në dijeni absolute se çfarë kishte ndodh apo ndodhte shtie në mënyrë të pa kontrolluar në drejtim të makinës që ishte para tij e cila ishte e të ndjerit T. B.. Siç rezulton nga vetë i dëmtuari A. N. në ato momente në afërsi të T. B.t në distancë prej 3 metra kishte qenë babai i A.it, P.u i cili po ashtu ka mund të goditet. Dhe pikërisht kur A.i i del përpara A.it i njëjti nga frika e godet në këmbë pa dashje për ta privuar nga jeta dhe me tu kthyer e sheh se T. po tenton të hyj në makinë dhe nga frika se po merrte armë shtie vetëm një herë në drejtim të tij duke e goditur në pjesë të poshtme nën vijën e abdomenit dhe distanca kishte qenë mbi një metër. Pra ishte goditur me një të shtënë të vetme në pjesën e poshtme abdominale.

Sa i përket motivit, i vetmi motiv i të akuzuarit A.GJ. është frika si pasojë e tronditjes mendore në momentin e kryerjes së veprës penale.

Si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka ardhë si pasojë shkelja e Ligjit Penal në dëm të akuzuarit A.GJ..

Mbrojtësi i të akuzuarit P.GJ., avokati Tomë Gashi në ankesën e tij vlerëson se aktgjykimi i shkallës së parë është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale nga neni 384 par.1 pika 1.12 të KPP pasi aktgjykimi është krejtësisht në kundërshtim me dispozitën e neni 370 par.7 të KPP nga se gjykata ka konstatuar fakte inegzistente në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar e të cilat janë në kundërshtim me provat e administruara. Dispozitivi i aktgjykimit është i pa kuptueshëm, konfuz, kundërthënës në brendinë e tij dhe me arsyetimin e aktgjykimit në raport me të akuzuarin P.GJ.. Nuk janë paraqitur arsyet për faktet vendimtare ndërsa ato të paraqitura janë të paqarta dhe kundërthënëse. Gjykata nuk ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse sa i përket vërtetimit të ekzistimit apo jo të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale për të akuzuarin P.ë GJ., duke i ndryshuar deklaratimet e dëshmitarit kryesor A. N. si dhe dëshmitarëve të tjerë të dëgjuar në prokurori dhe shqyrtim gjyqësor. Gjykata elementet e veprës penale dhe mënyrën dhe rrethanat që pretendon se janë kryer nga P.ë GJ., i ka vërtetuar krejtësisht

në kundërshtim me provat dhe atë me dëshminë e dëshmitarit A. N. i cili në prokurori ka deklaruar në pyetjen se “ a ka mujt me dal T. në drejtim të rrugës kryesore pa e larguar veturën P.a”, dëshmitari përgjigjet “nuk e di a ka qenë i larguar automjeti i Z. por nëse ka qenë ka mujt me dal” e këtë e ka konfirmu edhe në shqyrtimin gjyqësor se tani i ndjeri T. B. ka pasur që të kaloj me makinën e tij edhe pse ka pasur pak lloq. Ndërsa është e pa kontestushme dhe vërtetohet në bazë të deklaratës së Z.K. se ai pasi që ka dalur nga oda e A. N. dhe nuk është arritur marrëveshje dhe për shkak të bërtimave të T. B.t është nisur menjëherë me automjetin e tij në drejtim të shtëpisë së tij dhe pastaj ka dëgjuar të shtënat dhe ka vendosur që të kthehet tek vendi i ngjarjes – tek shtëpia e A. N.. Nga kjo vërtetohet se Z.K. e ka larguar automjetin e tij dhe T. B. ka mund të dal- kaloj me veturën e tij i pa penguar ashtu siç thot edhe A. N.. Këtë e thot edhe V. N. në shqyrtim gjyqësor se i ndjeri T. B. ka mund të kaloj me veturën e tij. Policia prokuroria dhe gjykata nuk e ka marr asnjëherë në pyetje dëshmitarin M.2. GJ. i cili është vllau i të akuzuarit P.GJ. për ta ndihmuar që ta kupton ecurin e shitblerjes së tokës mes tij dhe T. B.t. Në shkresat e lëndës është thënë se ka edhe CD me incizime të cilat i janë dorëzuar policisë. Gjykata është dasht të ftoj M.2. Gj. dhe K.H. i cili në deklaratën e dhënë në polici ka deklaruar se ka par armën në duart e dikujt e pastaj në bazë të informatës së të ndjerit T. B., sipas tij armët kanë qenë të varura në dyert e oborrit të shtëpisë P.ë GJ.. Nga ky dëshmitar do të vërtetohet fakti se as A.i dhe as P.i nuk kan pasur për qëllim që ta vrasin T. B..

Mbrojtja konsideron se edhe gjendja faktike është vërtetuar gabimisht dhe në mënyrë jo të plotë kur gjykata vlerëson se i akuzuari P. kinse me veprimet e veta i ka krijuar kushte djalit të tij A.GJ. për kryerjen e veprës penale për shkak të mosmarrëveshjeve pronësore që ka pasur me të ndjerin T. B. e që sipas mbrojtjes asnjë mosmarrëveshje P.GJ. nuk ka patur me të ndjerin T. B. pasi ai nuk ia ka shitur tokën që përmendët në aktgjykim por këtë e ka bë vllau i tij M.2. GJ.. Sa i përket bllokimit të rrugës me veturën e tij nga ana e P.ë Gj. kjo siç cekët më lartë është vërtetuar se nuk është ashtu në deklaratat e të dëmtuarit A. N. dhe Z.K.. Nuk është vërtetuar se P.GJ. ka thirrur djalin e tij në telefon pasi gjykata nuk ka vërtetu se në emër të kujt është emri i telefonit 044/306-902 dhe se ky numër del të jetë në emër të G. K. nga Rahoveci ndërsa si inkriminus e kanë paraqitur listingun sipas tyre të bisedave telefonike në ditën kritike nga ora 09:50 deri në orën 19:58 në mes këtij numri në numrin e A. Gj.dhe sipas arsytimit të gjykatës mes këtyre dy numrave ka pasur 25 thirrje dhe atë 14 para rastit dhe 11 pas rastit. Është e çuditshme se thirrja telefonike e pretenduar e P. Gj. për ta thirrur djalin e tij A.GJ. duke i thënë se jam tek shtëpia e A. M.3.it të pretendohet se është krim. Po ashtu është e pa vërtetë pretendimi i gjykatës se pas të shtënave nga A.i ata janë larguar me automjetin e P.GJ. pasi kjo nuk vërtetohet me asgjë dhe kjo demantohet nga deponimet e dëshmitarëve por edhe nga marrja e automjetit të A.GJ. nga policia. Si pasojë e shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale dhe vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike ka ardhë edhe deri te shkelja e Ligjit Penal në dëm të akuzuarit.

Gjykata e Apelit e Kosovës me vëmendje ka shqyrtuar ankesën e Prokurorisë, përfaqësuesit të palës së dëmtuar si dhe ankesat e mbrojtësve të akuzuarve dhe ka ardhë në përfundim se pretendimet e Prokurorisë dhe të mbrojtësve se aktgjykimi është i përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale janë të pa bazuara.

Aktgjykimi i shkallës së parë është i qartë dhe konkret dhe se gjykata ka dhënë arsyet për faktet vendimtare duke arsyetuar çdo pikë të aktgjykimit. Ka paraqitur në mënyrë të plotë se cilat fakte dhe cilat arsye i konsideron të vërtetuara apo të pa vërtetuara. Ka vlerësuar saktësinë e provave kundërthënëse, arsyet e mosmiratimit të propozimeve konkrete të palëve si dhe arsyet në të cilat është bazuar me rastin e vërtetimit të ekzistimit të veprës penale për të dy të akuzuarit.

Kjo gjykatë pajtohet me vlerësimin e gjykatës së shkallës së parë se nuk ka qenë e nevojshme ekzaminimi psikiatrik i të akuzuarit A.GJ. ashtu siç pretendon mbrojtja në ankesën e saj, për faktin se me asnjë provë nuk është provuar që i akuzuari të ketë vuajtur nga ndonjë sëmundje apo çrregullim psikik e po ashtu bazuar në provat e administruara ashtu siç ka rrjedhur ngjarja nuk ka ndonjë arsye të mendohet se i akuzuari ka qenë nën ndonjë presion apo situatë e cila te i njëjti do të kishte shkaktua një gjendje psikike të atillë siç pretendon mbrojtja.

Sa i përket pretendimit tjetër të mbrojtjes se nuk ka prova lidhur me bisedën telefonike që i akuzuari P.ë e ka bërë me të akuzuarin A. duke i thënë “jam te shtëpia e A. M.3.it”, një vlerësim i tillë është i pa bazuar për faktin që gjykata e shkallës së parë të njëjtën e ka trajtuar dhe e ka vlerësuar se kjo është provuar pa mëdyshje nga deklaratat e dëshmitarit A. N., SH. dhe V. N. e të cilat i ka arsyetuar gjykata e shkallës së parë në faqen 23 të aktgjykimit të shkallës së parë.

Pretendimi tjetër i mbrojtjes së të akuzuarit A.GJ. që ka të bëjë me deklarimin e fajësisë dhe mbrojtjen në heshtje edhe nën supozimin që të kenë ndodhur të njëjtat nuk paraqesin shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale që do të kushtëzonin anulimin e aktgjykimit duke pasur parasysh në anën tjetër vërtetimin përtej dyshimit mirë të bazuar të gjendjes faktike.

Gjykata e shkallës së parë deri te një gjendje faktike e drejtë dhe e plotë ka ardhë pas administrimit të provave personale dhe atyre materiale duke dëgjuar dëshmitarët A. N., V. B., Zef N., SH. N., V. N., Z.K. T. Gojani, J. GJ., L. B., ekspertët Dr. M. G. dhe Dr. D.H., ekspert mjeko ligjor si dhe eksperti L. Rr. ekspert për armë të zjarrit , daljen dhe rikonstruimin e drejtpërdrejtë të vendit të ngjarjes nga ana e trupit gjykues, prokurorit të shtetit, të dëmtarëve, përfaqësuesve të autorizuar të palëve të dëmtuara, të akuzuarve dhe mbrojtësve të të akuzuarve si dhe zyrtarëve policor nga Njësia e Forenzikës, leximi i deklaratës së të dëmtuarës K.B. e dhënë me 14.05.2019 në Prokurori, deklarata e dëshmitarit K.A.) H., e dhënë me datë 20.03.2019 në Stacionin Policor, leximin e provave materiale siç janë: raporti i hetuesit H. L.j, raporti i oficerit N. Rr., procesverbali mbi kontrollin e personit dhe banesës i datës 12.03.2019, listën e armëve të sekuestruara nga i akuzuari A.GJ. i datës 12.02.2019 nga ana e oficerit G. L., raporti i oficerit G. L., raporti i oficerit M. G., raporti i këqyrjes së vendit të ngjarjes me numër të rastit 2019-EA-243 i datës 12.03.2019 i përpiluar nga oficeri Sh. Z. së bashku me tabelën e matjeve dhe skicën e pa shkallëzuar me datë dhe numër të njëjtë, raporti mbi ekzaminimin e veturës së viktimës T. B. nga Njësia e Teknikes Kriminalistike e datës 12.03.2019 i përpiluar nga hetusi E. J. së bashku me foto albumin e bërë gjatë ekzaminimit nga foto 1 deri 51, raporti i hetuesit H. S. i datës 18.03.2019, raportet e oficerit M.G. të datës 20.03.2019, 27.03.2019 dhe 01.04.2010, raportet e oficerit M.G. i datës 08.04.2019, raportin e ekspertimit të Agjencisë të Kosovës për Forenzikë me numër AKF/2019-0912/2019 i datës 23.04.2019, listingun e hyrje- daljeve për numrat e telefonave të cilët i shfrytëzonte i pandehuri P.GJ. dhe i pandehuri A. Gj., me datë 12.03.2019, raporti i ekspertimit të Agjencisë Kosovare për Forenzikë me numër AKF/2019-0142 të datës 05.09.2019 që ka të bëjë me grimcat e barotit, raportet emergjente të Spitalit Rajonal “Isa Grezda” në Gjakovë me numër 4019 të datës 12.03.2019 në emër të të ndjerit viktimës T. B., raporti emergjent i Spitalit “Isa Grezda” në Gjakovë me numër 4020 të datës 12.03.2019 që ka të bëjë me të dëmtuarin A. N., raporti i ekspertizës së ekspertit mjeko ligjor Dr. D. H. i datës 05.06.2019 që ka të bëjë me të dëmtuarin A. N., raporti i autopsisë i Institutit të Mjeksisë Ligjore me numër MA 19-071 të datës 13.03.2019 i përpiluar nga Dr. M. G. me të cilin është bërë autopsia e viktimës T. B., shikimi i foto albumit të bërë nga Njësia e Teknikës Kriminalistike e datës 12.03.2019 nga foto 1 deri në 76 në 40 faqe, raportin e Njesisë Forenzike të Stacionit Policor në Gjakovë – mbi rikonstruimin e vendit të ngjarjes të bërë me datë 02.10.2020 i dorëzuar në gjykatë me datën 12.10.2020 së bashku me foto albumin nga fotografia 1 deri 40 në 21 faqe, fatura mbi tërheqjen e automjetit të tani të ndjerit T. B. të datës 08.04.2019 nga servisi “D....” fatura mbi tërheqjen e automjetit të akuzuarit A.GJ. të

datës 12.03.2019, dëftesa mbi kthimin e pronës përkatësisht veturës që e kishte viktimja T. B., pronarit B.SH. të datës 08.04.2019, vërtetimi mbi lirimin e seneve të sekuestruara nga viktimja T. B. i datës 12.03.2019, vërtetimet mbi sekuestrimet e përkohshme të sendeve (setrave me ngjyrë të zezë të sekuestruara nga të akuzuarit P.GJ. dhe A.GJ. të datës 12.03.2019 nga oficeri E.J., ka dëgjuar mbrojtjen e të akuzuarit P.GJ. ndërsa i akuzuari A.GJ. gjatë shqyrtimit gjyqësor ka shfrytëzuar të drejtën e tij ligjore është mbrojtur në heshtje nuk është deklaruar, nga të cilat prova pa mëdyshje u vërtetua se të akuzuarit kanë kryer veprat penale për të cilat janë shpallur fajtor nga ana e gjykatës së shkallës së parë.

Pretendimet e mbrojtjes se kemi të bëjmë me vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike nuk qëndrojnë duke pas parasysh se nuk ka qenë kontestuese çështja e një mosmarrëveshje në mes të P.GJ., vëllaut të tij M.2. GJ.j dhe të ndjerit T. B. lidhur me një tokë të cilën e kishte blerë i ndjeri T. B. nga vëllai i të akuzuarit P.ë, M.2. GJ.. Për këtë arsye edhe kjo gjykatë vlerëson se dëgjimi i dëshmitarit M.2. GJ.j është i panevojshëm për faktin se nuk ka qenë fare kontestuese fakti se mosmarrëveshja ka ndodhur për një parcelë të cilën M.2.i ia ka shitur T.s edhe pse prona ishte familjare ashtu që në rastin konkret ajo çka është me rëndësi është se i akuzuari A. a e ka vrarë të ndjerin T., për çka është krejt e pa rëndësishme motivi për te veprat penale të vrasjes për çka nuk kërkohet motivi te vrasjet e rëndomta, por e rëndësishmja është vërtetimi i dashjes si element qenësor i veprës penale e që në këtë rast u vërtetua përtej dyshimit mirë të bazuar. Po ashtu me rëndësi është vërtetimi i fakteve përmes provave lidhur me atë se i akuzuari P.GJ. a ka kryer veprën penale ndihmë në kryerjen e veprës penale të vrasjes.

Nga provat e administruara shihet se ditën kritike ashtu siç ka përkthuar gjykata në faqen 21-24 të aktgjykimit, i ndjeri T. B. kishte filluar ta pastroj - ti heq mexhet për pronën që e kishte blerë nga M.2. GJ., që vërtetohet përmes dëshmisë së V. dhe K.B.t. Me datë 10.03.2019 T. kishte thirrur K. H. që ti merr tre punëtor për ta pastrua dhe për ta rrethuar tokën e blerë. Dy punëtor ishin siguruar dhe kishin filluar të punojnë të nesërmen me datë 11.03.2019. Aty ishin paraqitur të dy të akuzuarit A. dhe P.ë GJ.j dhe iu kishte drejtuar P.a dëshmitarit K. H. me fjalët “kush të ka thënë të vish këtu” dhe pasi ia ka kthyer dëshmitari se i ka thënë “T. B.” i akuzuari P.ë i kishte thënë “menjëherë dil nga livadhi se nuk du me të marrë në qafë” dhe kishte ndërhyrë edhe i akuzuari A.GJ. duke ju thënë “nëse ndodh diçka mos thuaj se stë kam tregu, mos hyn në këtë tokë dhe kthej hunjtë në vendin e tyre” pastaj i është drejtuar i akuzuari P.ë të ndjerit T. me fjalët “kush të ka thënë me fillua punën në këtë tokë dhe çdo thupër që është prerë të kthehet në vend të vet ose ndryshe e zgjidhim këtë punë” ndërsa T. ishte përgjigjur “nuk kemi nevojë ta zgjedhim ndryshe sepse jemi njerëz ashtu që ju kishte thënë punëtorëve që ti vendosin hunjtë në vendin e tyre” ndërsa të akuzuarve iu kish thënë që të ulen në odën e burrave dhe ta zgjedhin pa probleme këtë punë.

Ditën kritike i ndjeri T. kishte shkuar tek shtëpia e A. N. për ta pritur M.2.in rreth problemit të parcelës mirëpo M.2.i nuk kishte ardhur me arsyetim “nuk po mundem me ardhë tek A.i nga se nuk kam mund me u marrë vesh me vëllain P.ën” e që vërtetohet nga dëshmitari A. N. ndërsa u vërtetua se P.a me vëllain e tij M.2.in nuk kishin arritur marrëveshje rreth parcelës së shitur nga M.2.i. Se i ndjeri T. ka thirrur dëshmitarin Z. Kita i cili është daja i të akuzuarit P.ë që të shkoj tek nipi i tij dhe të merren vesh se çka dëshiron prej tij e kjo u vërtetua edhe nga Z. por edhe nga A. N.. Z. kishte shkuar tek i akuzuari P.ë dhe kishte kërkuar që të shkojnë tek shtëpia e A. N. dhe ishin nisur secili me veturat e tyre ku ka qenë në këtë shtëpi të A.it edhe i ndjeri T. B.. I akuzuari P.ë e kishte parkuar veurën e tij prapa veturës së të ndjerit T. ndërsa dëshmitari Z. në anën e majtë të tij. Aty janë zhvilluar bisedat rreth kësaj parcelë dhe në fund nuk kishin arritur marrëveshje dhe i ndjeri T. është ngritur nga ndeja duke thënë “du me shkua këtë punë me lajmërua në polici me e

ndreq përmes policisë dhe gjykatës” Pra në esencë kjo ishte edhe arsyeja apo gjeneza e këtij konflikti në mes të familjes B. dhe GJ. e të cilat nuk ishin kontestuese.

Nuk është kontestues edhe fakti se A.GJ. kishte privuar nga jeta tani të ndjerin T. B. ashtu siç përshkruhet në dispozitiv të aktgjykimit dhe siç u përshkrua në gjenezën e fillimit të konfliktit. U vërtetua se i akuzuari P.ë e kishte telefonuar të akuzuarin A. që ishte në shtëpi duke i treguar se jam tek shtëpia e A. M.3.it dhe siç u cekë edhe më lartë kjo u vërtetua edhe nga dëshmia e dëshmitarit A. N. e po ashtu edhe nga SH. dhe V. N. të cilët kanë deklaruar se ka qenë duke fol P. me dikend në telefon dhe duke i treguar se “jam te shtëpia e A. M.3.it e në anën tjetër nga provat tjera materiale siç është raporti i listingut të hyrjeve dhe daljeve nga lista e PTK-së për numrat e telefonit të të akuzuarve vërtetohet se natën kritike 5 minuta para se me ndodh rasti kishin komunikuar 3 herë brena pak minutave ashtu që i akuzuari A. pas marrjës së telefonatës merr pushkën automatike që e ka mbajtur pa autorizim dhe niset për në shtëpinë e A. N. e që është vërtetuar nga vetë deklarimi i të akuzuarit A. gjatë rekonstruimit të vendit të ngjarjes ku e ka përshkruar ardhjen e tij nga shtëpia në vendin e ngjarjes. Se nuk ka qenë kontestuese se i ndjeri T. ka qenë në veturën e tij që e kishte të ndezur dhe priste lirim të rrugës për tu nisur në shtëpinë e tij dhe kjo u vërtetua nga dëshmia e dëshmitarit A. N. që ka deklaruar se T. ka qenë në veturë, vetura ka qenë e ndalur dhe ka qenë e ndezur. Është vërtetuar po ashtu nga ky dëshmitar por edhe nga ekzaminimi i vendit të ngjarjes se me të ardhur në vendin e ngjarjes i akuzuari A. ka shkuar tek dera e veturës së T.s dhe ka gjuajtur me automatikë 10 herë e kjo u vërtetu edhe nga dëshmitarja SH. N. që ka deklaruar se i njëjti ka gjuajtur në veturë me automat dhe këto dëshmi janë në përputhje të plotë me raportin mbi ekzaminimin e veturës së T. B.t ku shihen 9 frimat tek dera e parë e shoferit dhe një vrimë në pjesën e pasme e evidentuar si dëshmia 10.

Sa ishte duke gjuajtur i akuzuari A. në drejtim të veturës së të ndjerit T. kishte ndërhyrë dëmtuari A. për ta ndihmuar punën ashtu që i akuzuari A. i është kthyer të dëmtuarin A. duke e gjuajtur me pushkë automatike në këmbë në pjesën e përfundshme të gjurit dhe e kishte goditur me kondak të pushkës në pjesën e ballit ku i dëmtuari A. rrëzohet dhe gjatë kësaj kohe i ndjeri T. arrin të dalë nga automjeti për tu nisur në drejtim të Drinit. Me të vërejtur të ndjerin T. i akuzuari A. përsëri ka gjujt me pushkë automatike në drejtim të ndjerit duke e goditur me një plumb në pjesën e poshtme të anës së majtë ku edhe ishte rrëxuar, fakt ky i provuar përmes dëshmisë së A. dhe SH. N. e që plumbi ka qenë fatal dhe kjo vërtetohet edhe përmes autopsisë por edhe dëgjimit të ekspertit mjeko-ligjor Dr M. G..

Pretendimi i mbrojtjes se nuk është e vërtetë se i akuzuari P.ë është larguar nga vendi i ngjarjes së bashku me të akuzuarin A. me një veturë demantohet përmes dëshmisë së dëshmitarit A. N. i cili e ka paraqitur qartë me deklaratën “e di që më kanë rrah përkaj A.i dhe P.a dhe kanë hipur në veturë të dy, e kanë kthyer veturën dhe kanë shkuar.

Me të drejtë gjykata e shkallës së parë e vlerëson pretendimin e mbrojtjes së të akuzuarit A. se nuk e kishte dashje të drejtëpërdrejtë pra se ka munguar dashja nga i akuzuari A. pasi që i njëjti nuk ka qenë i involvuar në kontestin pronësor, si të pa bazuar për faktin se i akuzuari A. ka qenë i njoftuar jo vetëm me faktin që e cekë gjykata e shkallës së parë se kanë jetuar në një bashkësi familjare me babanë e tij P.ën por edhe për faktin se siç u cekë më lartë që kishte qenë prezent një ditë përpara me babain e tij kur ja kishin ndalur punimet dëshmitarit K. H. dhe dy punëtorëve të tij që ishin angazhuar nga T. B. dhe pikërisht ishte i akuzuari A. i cili i kishte thënë K.it “nëse ndodh diçka mos thuaj se stë kam tregu, mos hyn në këtë tokë dhe kthej hunjtë në vendet e tyre”, fakt ky i cili nuk ka qenë kontestues dhe është pohuar edhe nga vetë i akuzuari P.ë GJ. si dhe faktin se i njëjti ka treguar se i njëjti ka qenë prezent kur P.u dhe M.2.i kan biseduar rreth shitjes së tokës dhe se nuk janë marrë vesh.

Nga gjitha provat e administruara demantohet mbrojtja e të akuzuarit A. lidhur me dashjen për ta privuar nga jeta të ndjerin T. se kinse ka qenë në gjumë dhe se nëna e tij J. i kishte thënë se po ndodh diçka tek shtëpia e A.it dhe aty ishte edhe P.a, si dhe në vendin e ngjarjes ka par viktimën duke lëvizur në drejtim të veturës dhe ka shtënë me armë në drejtim të viktimës janë të pa bazuara dhe nuk bazohen në asnjë provë konkrete dhe në kundërshtim me provat tjera si dhe një situatë e tillë nuk ishte theksuar në deklaratën e tij dhënë në prokurori se armën e ka marr nga frika, se mund ti ndodh babait të tij ndonjë fatkeqësi dhe se nuk ishte vërejtur lëvizjet e të ndjerit T. ndërsa në anën tjetër është vërtetuar me prova të cekura më lartë se i ndjeri kishte qenë brenda në veturë dhe me të drejtë nuk ia ka falur besimin dëshmitares J. GJ., arsyetimin përkitazi me këtë dëshmitar e pranon në tersi edhe kjo gjykatë pa patur nevojë që të elaborohet edhe njëherë.

Sa i përket pikës dy të aktgjykimit bazuar në dëshminë e të dëmtuarit A. N. dhe veprimet e të akuzuarit me të drejtë gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar se pretendimet e prokurorisë nuk mund të qëndrojnë dhe se veprimet e të akuzuarit nuk vërtetojnë dashjen që i akuzuari A. ta kishte për të tentuar ta privonte nga jeta të dëmtuarin A. N.. Dëshmia e dëshmitarit A. tregon se distanca ka qenë mes tij dhe të akuzuarit A. rreth gjysmë metre dhe se i akuzuari ka gjuajtur me automatik në këmbë në pjesën e përfundi gjurit në këmbën e majtë dhe tjetrën në këmbën e djathtë përfundi muskulit dhe e ka goditur me kondak në ballë ku edhe është rrëzuar. Pra duke pas parasysh faktin se i njëjti kishte gjuajtur në pjesët e poshtme të këmbës pavarësisht se ishte afër dhe duke e goditur me kondak tregojnë se tek i njëjti nuk ka ekzistuar dashja për privim nga jeta pasi që qëllimi i tij ka qenë privimi i jetës të të ndjerit T. B. dhe në anën tjetër edhe deklarimi se A.i dhe P.a i kanë kaluar pastaj përskaj dhe kanë hipur në veturë tregon mos dashjen për privim nga jeta.

Sa i përket pikës 4 të aktgjykimit që ka të bëjë me të akuzuarin P.ë GJ. edhe te ky i akuzuar gjykata e shkallës së parë përtej dyshimit mirë të bazuar vërtetoi se në veprimet e të njëjtit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të ndihmës në kryerjen e veprës penale të vrasjes. Dashja e të akuzuarit P.ë vërtetohet së pari nga thirrjet që ia kishte bërë të akuzuarit A. menjëherë pas daljes nga oda, 5 minuta para se të ndodh rasti duke komunikuar 3 herë ku dëshmitarët siç u cekë edhe më lartë A., SH. dhe V. N. e kanë dëgjuar të akuzuarin duke thënë “jam te shtëpia e A. M.3.it, pastaj dëshmitari – i dëmtuari A. gjatë shqyrtimit kishte deklaruar “A.i nuk ka bisedua me P.ën, unë kam qenë 3-4 metra larg veturës së T.s, ashtu që A.i si ka ardhur ka shkuar te dera e veturës së T.s, ka gjuajtur me automatik, nuk e di sa herë. Se P.a ka shkuar bashkë me A.in tek vetura e T.s dhe A.i ka qenë tek dera e parë ndërsa P.a ka qenë tek dera mbrapa veturës. Ka deklaruar më tutje “... pasi T. është rrëzuar, e di që më kanë ra përskaj A.i dhe P.a dhe kanë hipur në veturë të dy ...” kështu që gjykata e shkallës së parë me të drejtë ka vlerësuar se është vërtetu raporti apo lidhja subjektive midis ndihmësit dhe kryerësit të veprës penale dhe se nuk qëndron pretendimi i mbrojtjes se P.a nuk ka krijuar kushte dhe nuk ka penguar të ndjerin T. që të lëvizë, sepse kjo është në kundërshtim me dëshminë e dëshmitares SH. N. e cila ka deklaruar se “prej vendit ku ka qenë vetura e P.ës dhe vetura e T.s dhe nëse kishte qenë edhe vetura e P.ës aty, nuk ka mundur me u largu me veturë T. nga se ka qenë lloq dhe ka qenë një vij që tash e kanë rregullua dhe e kanë bërë asfalt. Se e ka dëgjuar T.n duke i thënë P.ës “lëshoma rrugën”. Dëshmia e dëshmitares SH. është përputhur në tersi në konstatimet e bëra gjatë rekonstruimit të vendit të ngjarjes e deklarimi i saj ka qenë në përputhje edhe me fotot që ishin bërë natën kritike ku shihet balta në rrugë e po ashtu edhe me dëshminë e dëshmitarit A. dhe dëshmitares V. N. si dhe dëshmitarit Z. K. të cilët kanë deklaruar se i ndjeri T. nuk ka mundur të dal për shkak të veturës së të akuzuarit P.ë. Prandaj bazuar në atë se i ndjeri e kishte kthyer veturën, ishte ndalur, kishte kërkuar nga i akuzuari P.ë ti lirohej rruga, se rruga kishte qenë me shumë baltë, ishte edhe kanali i hapur, vërtetohet se i ndjeri kishte pengesa për të lëvizur me automjetin e tij. I akuzuari P.ë i kishte krijuar këto kushte sepse e dinte se i akuzuari A. ishte duke ardhur dhe nga dëshmitarët është vërtetuar se

ai kishte qëndruar tek dera e automjetit të tij me telefon në dorë duke biseduar , e që nga listingu i thirrjeve vërtetohet se ka qenë duke biseduar me të akuzuarin A.. Se dëshmitarja SH. N. ndër të tjera kishte deklaruar se A.i i kishte thënë T.s të hyjnë brenda se po dukët si kurthë sepse P.a që ishte duke fol me telefon nuk ja lëshonte rrugën T.s ndërsa dëshmitarja V. N. ka theksuar “T. nuk ka pasur kah me dal....., P.a e ka qelë derën e veturës së tij dhe i njëjti nuk ka hyrë asnjëherë në veturë por ka ndejtë jashtë, u sillte rreth veturës dhe ka fol me dikend në telefon”.

Sa i përket pretendimeve të mbrojtjes se thirrjet ishin realizuar para vrasjes nga anëtarët tjerë të familjes GJ., kjo gjykatë po ashtu mbështetë arsyetimin e gjykatës së shkallës së parë pa pasur nevojë një elaborim më të thukët.

Meqë aktgjykimi i shkallës së parë nuk është përfshirë me shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale si dhe gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë nuk kemi as shkelje të Ligjit Penal e që do të kushtëzonte anulimin e aktgjykimit.

Duke vlerësuar çështjen përkitazi me pretendimet ankimore të prokurorisë, palës së dëmtuar dhe mbrojtjes së të akuzuarve A.GJ. dhe P.ë GJ., lidhur me vendimin për dënim kjo gjykatë konsideron se ankesat janë të pa pabazuara. Në ankesat e tyre nuk ceket ndonjë rrethanë e re e që do të ndikonte në dënimin e shqiptuar apo të cilën nuk e ka pasur të njohur gjykata e shkallës së parë me rastin e vlerësimit të rrethanave që ndikojnë në lartësinë e dënimit. Në ankesën e Prokurorisë theksohet se dënimi jo vetëm që nuk është në proporcion me sjelljet e të pandehurve por me dënimet e shqiptuara nuk mund të arrihet efekti i një dënimi meritator si dhe do të ndikoj negativisht si te i pandehuri ashtu edhe në opinion në rrethin ku jetojnë të pandehurit dhe se do të inkurajoj që edhe të tjerët të sjellën në këtë mënyrë si të pandehurit. Përfaqësuesi i autorizuar i palës së dëmtuar av. N.B. vlerëson se nuk janë vlerësuar drejtë të gjitha rrethanat rënduese si dhe dashja direkte për privimin nga jeta të të ndjerit T. B., shkalla e lartë e dashjes, vendosmëria për ta kryer vrasjen, gjuajtja direkte ndaj viktimës me armë, dëmi i shkaktuar familjes së të ndjerit, moshja e re e viktimës, viktima nuk ka provokuar, ka kërkuar mbrojtje gjyqësore dhe me asnjë aktveprim nuk ka kontribuar që i akuzuari ta kryej vrasjen. Mbrojtësja e të akuzuarit A.GJ. av. Kosovare Kelmendi thekson se përkitazi me pikën 1 të aktgjykimit vendimin mbi dënim nuk do ta arsyeton sepse aktgjykimi është i pa ligjshëm në kuptim të kualifikimit juridik të veprës si dhe mohimit tërësisht të kryerjes së veprës penale të vrasjes meqë nuk ka pas dashje për privim nga jeta. Sa i përket pikës II dhe III dënimi është tejet i lartë bazuar në një mori rrethanash lehtësuese lidhur me këto dy vepra dhe se gjykata është dashur të shqiptoj një dënim më të butë. Mbrojtësi i të akuzuarit P.ë GJ. av. Tomë Gashi thekson se në rastëse mos aprovimit të propozimeve të mbrojtjes nga ana e Gjykatës së Apelit, gjykata ta ndryshoj vendimin sa i përket vendimit duke marrë parasysh rrethanat lehtësuese të parafrazuara në aktgjykim por që nuk i janë dhënë mundësi e veçantë. Se kemi dy anëtarë të familjes të dënuar, se i mbrojturi i tij është i martuar, baba i 5 fëmijëve, më parë i pa gjykuar, rrethana këto që ndikojnë të shqiptohet dënim më i butë mundësisht i kushtëzuar.

Mirëpo, Gjykata e Apelit duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese që i pati parasysh edhe Gjykata e shkallës së parë dhe atë si rrethana rënduese mori shkallën e lartë të dashjes duke marrë pushkën automatike nga shtëpia e tij tek vendi i ngjarjes dhe fillimisht duke gjuajtur 10 fishek në drejtim të veturës së viktimës, pastaj gjuajtja në të dëmtuarin A. i cili përpigjej ta ndalonte të akuzuarin A., pastaj të shtënë tjetër ndaj viktimës që ikte në drejtim të Drinit, tregon vendosmërinë e të akuzuarit për ta krye veprën penale, mënyrën e kryerjes së veprave penale duke qenë i armatosur me armë dhe duke privuar nga jeta të ndjerin T. dhe duke i shkaktuar lëndime të rënda trupore me armë të dëmtuarit A., rrezikimin dhe dëmtimin e vlerës së mbrojtur siç është jeta e njeriut, shkallën e dëmit shkaktuar familjes duke lënë jetim tre fëmijët e të

ndjerit dhe bashkëshorten e re. Ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë sjelljen e tij gjatë seancave të shqyrtimit gjyqësor, qëndrimi tejet korrekt, më parë i pa dënuar. Për të akuzuarin P.ë shkallën e lartë të dashjes duke thirrë në telefon të akuzuarin A. dhe duke mos larguar veturën e tij për të lëvizur i ndjeri për ta vënë në kurthë dhe duke e ditur qëllimin e të akuzuarit A.. Si rrethanë lehtësuese moshën e tij 60 vjeçare, sjellja dhe qëndrimi korrekt në gjykatë si dhe më parë nuk ka qenë i dënuar. vlerëson se dënimi i shqiptuar ndaj të akuzuarve nga ana e gjykatës së shkallës së parë është në harmoni me intensitetin e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale dhe shkallës së përgjegjësive penale të akuzuarve si ekzekutor, gjykata e shkallës së parë ka shqiptuar dënimin e paraparë ligjor dhe se me këto dënime do të arrihet qëllimi i ndëshkimit i paraparë me nenin 38 të KPRK.

Nga sa u tha më lartë, e në pajtim me dispozitën e nenit 401 të KPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.201/2021, më 16.06.2021

Procesmbajtëse,
Leonita Lajçi

Kryetar i kolegjit- gjyqtari
1.Vaton Durguti _____

Anëtarët e kolegjit:

2. Dr.sc.Driton Muharremi _____

3.Afrim Shala _____